Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e \_\_\_\_\_ të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë, si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të ekzekutimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**V ula**

**Shtojca 6**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË**



### Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet



nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 160, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

## **Shtojca 7**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 76 të LPP Nr. 162 dt. 23.12.2020,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.





**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Në rastet e grupeve ekonomike të operatorëve ofertues do të zbatohet Neni 14 pika 2 te Ligjit 162/2020 ku citohet:**

*2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.*

*Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.*

**Mbeshtetur ne sa me siper nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohet:**

**Një Kontratë Bashkëpunimi e hartuar ndërmjet palëve, në të cilën anëtarët e bashkimit të caktojnë: Përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës, si dhe**

**Përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim dhe pjesën e furnizimit që do të kryejë secili nga anëtarët e bashkimit.**

**Në rast të shpalljes fitues, bashkimi i operatorëve ekonomikë duhet që Kontratën e Bashkëpunimit të sipërpërmendur, ta paraqesë si një Kontratë Bashkëpunimi të noterizuar.**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;

c. Formularin e sigurimit te ofertes sipas Shtojces 1/2;

ç. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

d. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

dh. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;



e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

1. Xhiroja mesatare vjetore gjate tre viteve të fundit(2018,2019,2020) duhet të ketë një vlerë jo me te vogel se vlera limit të kontratës që prokurohet .

Kjo do te vertetohet duke paraqitur vertetim per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit leshuar nga administrata tatimore.

2.Kopje te certifikuara te bilanceve tre viteve të fundit(2018,2019,2020)te konfirmuar nga organi kompetent.

### **2.2 Për kapacitetin teknik:**

#### **I.Lidhur me pervojen e meparshme:**

1. Sherbime të mëparshme te ngjashme me vlere jo më pak se 40% te vleres te perlllogaritur te kontrates qe prokurohet të realizuara gjatë tre viteve të fundit .

*-Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me ente publike, duhet te paraqiten:*

1. Kontrate

2.Vertetim nga Investitori ku të përcaktohet kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar si dhe permbushja me sukses e kontrates se sherbimit.

3. Faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara;

*-Kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me sektorin privat, duhet te paraqiten:*

1. Faturat tatimore të shitjes dhe ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara;

#### **II.Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat si me poshte**



- Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur Çertifikaten ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit te cilesise”
- Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur Çertifikaten ISO 14001: 2015 Per menaxhim mjedisi
- Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me Çertifikaten OHSAS 18001:2007, Per manaxhim të shëndetit dhe sigurimit në punë ose me certifikaten ekuivalente me te ISO 45001-2018 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”

Çertifikatat kerkohet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit, dhe te jene ne perputhje me nenin 30 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014, i ndryshuar.

Ne rast se dokumentet e mesiperme jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

### III.Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

#### Kategoria Klasifikimi Emertimi i kategorise

N.P. 12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

### IV.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;

- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)

### V.Deshmi per fuqine mesatare punetore te operatorit ekonomik:

Një punësim mesatar i të paktën **7 (shtate) personave**, per periudhen **shkurt 2021-prill 2021** dokumentuar kjo me vertetimin e kontributeve te sigurimeve shoqerore e shendetesore leshuar nga Administrata tatimore.

### VI. Deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion me kapacitet mbajtes deri ne pese ton	cope 1	ne pronesi ose me qera

Ne rast se mjeti i transportit eshte ne pronesi te paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e pronesise ,certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe ne rast se eshte me qera te paraqitet kontrata e qerases e shoqeruar me lejen e qarkullimit te qeradhenesit, certifikaten pronesise ,certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit.



Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 8

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### **MIREMBAJTJA E VARREZAVE PUBLIKE DHE TE DESHMOREVE ( PER NJE VIT)**

##### **I. Objekti : Pastrim parcelash , rruge dhe sheshe te brendeshme ndermjet blloqeve te varrimit**

1. Ne zerin “**Pastrim parcela sipërfaqe e gjelbert (2 here ne vit)**” kemi parasysh pastrimin e parcelave nga barerat e keqia qe mund te dalin brenda tyre . Pastrimi te behet ne sezonet ku keto barera kane procesin e rritjes se tyre.
2. Ne zerin “ **Pastrim parcela nga mbeturinat ( 24 here ne vit)**” te kihet parasysh pastrimi i parcelave nga mbeturina te ndryshme ( shishe, letra, gure, etj). Kur ka festa te ndryshme fetare dhe fluksi i njerezve eshte me i madh te kihet parasysh qe pastrimi te behet me dendur me qellim qe parcelat te jene te pasterta.
3. Ne zerin “**Heqja e barerave te keqia ne rruge e sheshe (2 here ne vit)**” Heqja e barerave do te behet sipas sezonit.
4. Ne zerin “ **Pastrim rruges me fshese (365 here ne vit)**“ te kihet parasysh qe rruget te fshihen cdo dite. Pastrimi te jete sa me cilesor duke perfshire rruget e cdo kategorie brenda territorit te varrezave. Siperfaqja e tyre pasqyrohet ne preventiv dhe ne harten treguese.
5. Ne zeri “ **Transport auto mbeturina te ndryshme** “ te kihet parasysh qe mbeturinat te cohen vendin e caktuar per grumbullimin e tyre. Nuk duhet lejuar qe te kete grumbullim te madh te mbeturinave port e hiqen cdo dite.

##### **II. Objekti : Mirembajtje drure dhe shkurre dekorative**

1. Ne zerin “ **Krasitje drure dekorative ( 2 here ne vit )**” , te kihet parasysh qe krasitja e tyre te behet brenda kushteve teknike ne sezonin e duhur.
2. Ne zerin “ **Krasitje drure dekorative ( nje here ne vit)**” te kihet parasysh qe te prashiten te gjitha druret dekorative qe ndodhen ne territorin e varrezave . Prashitja te behet brenda kushteve teknike dhe ne sezonet qe i permbahen ketyre kushteve.
3. Ne zerin “ **Luftim i semundjeve ne drure ( nje here ne vit)**” te kihet parasysh qe mjekimi i tyre te behet me medikamente me cilesi te larte . Mjekimi i pemeve te behet ne sezonin e duhur.



### III. Objekti “ **Kositje , grumbullim dhe transport bari** “

1. Ne zerin “ **Kositje , grumbullim dhe transport bari ( kater here ne vit )**”te kihet parasysh qe bari te kositet ne permasat qe permbajne kushtet teknike. Kositja te kryhet kater here ne vit ne sezonet qe i percaktojne keto kushte teknike.

### IV. Objekti “ **Mirembajtje bordure betoni te brendeshme**”

1. Ne zerin “ **Mirembajtje bordure betoni te brendeshme**” te kihet parasysh qe bordurat te mirembahen ne cdo kohe te vitit.

### V. Objekti : “**Lyerje me gelqere te bordurave dhe pemeve**”

1. Ne zerin “ **Lyerje me gelqere te bordurave dhe pemeve**” te kihet parasysh qe lyerja te kryhet Brenda kushteve teknike dhe ne te gjithe siperfaqen e percaktuar. Lyerja me gelqere ne varrezat e deshmoreve te behet dy here ne vit me rastin e festive qe festohen aty. Lyerja ne varrezat publike duhet te behet per bordurat dhe pemet.

### VI. Objekti : “**Sherbim perkujdesje gjate nates ne varrezat publike dhe ne varrezat e deshmoreve**”

1. Zeri “**Sherbim perkujdesje gjate nates ne varrezat publike dhe ne varrezat e deshmoreve**”

Ky sherbim do te realizohet cdo dite turni i trete ne varrezat publike dhe ne varrezat e deshmoreve dhe perfshin:

- Perkujdesjen per territorin e varrezave per te mos lejuar demtimin e tyre nga njerezit apo kafshet.
- Kujdesje per moshperdorimin e ujit dhe te energjise elektrike.
- Kujdesje per materialet e punes (pllaka rrethime) dhe veglat e punes.

### VII. Objekti “ **Mirembajtje e varrezave te deshmoreve**”

1. Ne zerin “**Pastrim i varrezave te deshmoreve ( mermeri) , heqja e barishteve te keqia nga rruge e sheshe dhe pastrimi I tyre + transport mbeturina**” ( muaji prill), te kihet parasysh qe varret e demtuara nga shkarjet dhe zhvendosjet te kthehen ne gjendjen e meparshme , shkronjat te lyhen me varak me ngjyre , gdhendjen e tyre ne pllakat e reja qe zevendesohen.

### VIII. Objekti “**Mirembajtja e varrezave te deshmoreve nga amortizimi**”

1. Ne zerin “ **Mirembajtje e varrezave te deshmoreve nga amortizimi vjetor dhe rifreskimi i germave ( nje here ne vit)** “ te kihet parasysh qe varret e demtuara nga shkarjet dhe zhvendosjet te kthehen ne gjendjen e mepareshme , shkronjat te lyhen me varak me ngjyre , gdhendjen e tyre ne pllakat e reja qe zevendesohen , etj.



**IX.. Objekti : “ Konsumi i ujit te pijshem per mirembajtje dhe nevojat e qytetareve “**

1. Ne zerin “**Konsum i ujit mesatar vjetor**” te kihet parasysh qe uji te perdoret vetem per qellimet e percaktuara ne objektin e ketij zeri.

**Sherbimi funeral brenda varrezave publike do te realizohet nga shoqeria fituese e tenderit per mirembajtjen e varrezave publike dhe te deshmoreve, sipas koston te paracaktuar nga Bashkia Korce per kryerjen e sherbimit funeral per te rritur dhe te vegjel, ku perfshihen punimet ne zera si me poshte**

**Sherbimi funeral per te rritur dhe te vegjel**

1	Fole e parapregatitur beton/arme
2	Kapak te pregatitur beton/arme
3	Ndertim varri provizor
4	Montim varri
5	Hapje varri

**Zhvarim varri mbi truall**

1	Germim+ mbushje dheu me krah toke kateg e IV

**Zhvarim varri ekzistues**

1	Cmontim varri ekzistues
2	Germim+ mbushje dheu me krah toke kateg e III

**Per cdo sherbim funeral qe do te kryhet nga subjektet private te licensuar per keto lloj sherbimesh, do t’i parapaguaje shoqerise fituese vleren e paracaktuar nga Bashkia Korce per sherbimin qe do te kryeje shoqeria fituese .**

Per mirembajtjen e verrezave dhe sherbimin publik te varrimit do te zbatohen edhe kushtet e percaktuara ne legjislacionin e fuqi per kete sherbim :Ligjin nr. 9220 dt.15.4.2004, “Mbi sherbimin publik te varrimit”I ndryshuar, ne V.K.M. nr.711 dt. 29.10.2014 “Per miratimin e rregullores. Per administrimin dhe funksionimin e varrezave ne territorin e Republikes se Shqiperise,, dhe ne V.K.M. nr.712 dt. 29.10.2014 “Per miratimin e rregullores teknike, Per projektimin dhe ndertimin e varrezave ne territorin e Republikes se Shqiperise”.

**Shtojca 9**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I**



## KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

### Shtojca 10

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **Shërbimi që kërkohet: mirembajtja e varrezave publike dhe te deshmoreve te qytetit te Korces .**

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga data e lidhjes te kontrates



## Shtojca 11

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### TERMAT E REFERENCËS

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: mirembajtja e varrezave publike dhe te deshmoreve te qytetit te Korces sipas pershkrimit te bere ne specifikimet teknike.**

Vendi dhe dorezimi i shërbimeve:

**Varrezat publike dhe varrezat e deshmoreve te qytetit te Korces**

## Shtojca 12

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

### NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” .

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.





Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

### Shtojca 13

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_



Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 97 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020“Për prokurimin publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]



## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit: \_\_\_\_\_

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_



(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**



## Shtojca 15.

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME** **Shërbimet –Procedure e hapur e thjeshtuar**

#### **Neni 1: Qellimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar ne ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.



- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.



- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### **Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuar ne përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

### **Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

- 9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.
- 9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjëse përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

### **Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

- 10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

### **Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

- 11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.



- 11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
